



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. 3249/prot.

Himarë, më 13.07.2023

PROJEKTVENDIM

Nr. 23 datë, 13.07.2023

Për disa ndryshime në vendimin nr. 56 datë 24.11.2022

“Për miratimin e numrit të përgjithshëm dhe nivelin e pagave të punonjësve të Bashkisë Himarë për vitin 2023”

Në mbështetje të nenit 54 të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, nenit 9, të ligjit nr. 35/2023, “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”, ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, VKM nr. 142, datë 12.03.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura” i ndryshuar, VKM nr. 514, datë 20.09.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP) të rishikuar”, VKM nr. 328, datë 31.05.2023 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, VKM nr. 326, datë 31.05.2023 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”, VKM nr. 175, datë 08.03.2017 “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë, në arsimin parauniversitar”, i ndryshuar me VKM nr. 241, datë 20.04.2023, VKM nr. 350, datë 19.04.2017 “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, i ndryshuar VKM nr. 240, datë 20.04.2023, VKM nr. 325, datë 31.05.2023 “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”,

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimit të nivelit të pagave të punonjësve të Bashkisë Himarë për vitin 2023, të pasqyruara në lidhjet nr. 1,2,3,4,5,6,7 e 8 sipas aneksit bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, fillojnë nga data 1 prill 2023 dhe përballohen nga buxheti i Bashkisë Himarë për vitin 2023.

3. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet *drejtoria e burimeve njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse dhe drejtoria e financës, e planifikimit të buxhetit dhe e integritetit evropian.*

Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i dryshuar.

KRYETARI I BASHKISË

Jorgo Goro

Drejtore i DFPBIE

Laert Mezani



Drejtore i DBNJSHM

Andon Xani

DREJTORIA JURIDIKE

Klelli Muharremi

Lidhja nr. 1 – Niveli i pagave për funksionarët dhe nëpunësit civil.

Klasa	Kategoria	Emërtesat e pozicioneve të punës	Paga e grupit	Shtesa për vjetërsi	Shtesa për pozicion
	Pika d, e lidhjes nr.1	Kryetar			125.000
	Pika d, e lidhjes nr.1	Nënkryetar			90.000
I	I-b	Sekretar i Përgjithshëm	1	2%	80.000
	II-b	Sekretar i Këshillit Bashkiak	1	2%	70.000
	III-a/1	Këshilltar i Kryetarit	1	2%	56.000
	IV-b	Sekretar i Kryetarit	1 ose 2 ose 3	2%	34.500
II	II-b	Drejtor drejtorie	1	2%	70.000
III	III-a/1	Përgjegjës sektori	1	2%	56.000
IV	IV-a	Specialist/ Inspektor	1 ose 2 ose 3	2%	41.600
IV	IV-b	Specialist	1 ose 2 ose 3	2%	34.500
	III-a/1	Kryeinspektor i IMT-së	1	2%	56.000
	IV-a	Inspektor i IMT-së	1 ose 2 ose 3	2%	41.600

Shtesa për vjetërsi në punë, që jepet në masën 2% për qind, pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, llogaritet mbi shtesën e nivelit të kualifikimit. Për efekt të llogaritjes së kësaj shtese, “vite pune” do të konsiderohet vjetërsia e përgjithshme në punë, e dokumentuar në librezën e punës së çdo punonjësi, apo, në mungesë të librezës së punës, me çdo dokument tjetër ligjor, të lëshuar nga organet kompetente përkatëse sipas legjislacionit në fuqi, me përjashtim të viteve të sigurimit vullnetar, vetëpunësimit, shërbimit ushtarak të detyrueshëm, viteve të shkollimit në institucionet e arsimit të lartë, si dhe periudhës së trajtimit me pagesë papunësie.

Lidhja nr. 2 – Niveli i pagave për punonjësit administrativë.

Emërtesat e pozicioneve të punës	Paga bazë	Vjetërsia
Punonjës administrativë	47.000	1%

Punonjësit administrativë, përveç pagës bazë, përfitojnë shtesën për vjetërsi në punë. Kjo shtesë aplikohet në masën 1 për qind mbi pagën bazë të përcaktuar për çdo klasë. Për llogaritjen e kësaj shtese merret për bazë vjetërsia e përgjithshme në punë, por jo më shumë se 25 vjet.

Lidhja nr. 3 – Niveli i pagave për punonjësit e policisë bashkiake.

Emërtesat e pozicioneve të punës	Paga bazë	Vjetërsia
Kryeinspektor i policisë bashkiake	68.000	1%
Inspektor i policisë bashkiake	60.000	1%
Punonjës i policisë bashkiake	55.000	1%

Punonjësit e policisë bashkiake, përveç pagës bazë, përfitojnë shtesën për vjetërsi në punë. Kjo shtesë aplikohet në masën 1 për qind mbi pagën bazë të përcaktuar për çdo klasë. Për llogaritjen e kësaj shtese merret për bazë vjetërsia e përgjithshme në punë, por jo më shumë se 25 vjet.

Lidhja nr. 4 – Niveli i pagave për punonjësit mbështetës në Bashkinë Himarë.

Emërtesat e pozicioneve të punës	Klasa	Vjetërsia	Paga bazë
Manovrator	XIII	1%	46.700
Roje mjedisore/pyjesh me arsim të lartë	VIII	1%	44.100
Roje mjedisore/pyjesh me arsim të mesëm	VII	1%	43.600
Kujdestare çerdhe	VII	1%	43.600
Teknikë të mesëm të specialiteteve të ndryshme	V	1%	42.800
Elektricitist	V	1%	42.800
Magaziniar	IV	1%	42.500
Shofer	III	1%	41.800
Punonjës mirëmbajtës të profesioneve të ndryshme	III	1%	41.800
Punëtor mirëmbajtje	III	1%	41.800
Punëtor mirëmbajtje gjelbërimi	I	1%	40.000
Punëtor pastrimi/Sanitar	I	1%	40.000
Roje objektsh	I	1%	40.000

Lidhja nr. 5 – Niveli i pagave për punonjësit mësimorë të institucioneve të arsimit parashkollor. Bazuar në vendimin nr. 175, datë 08.03.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë, në arsimin parauniversitar”, i ndryshuar me VKM nr. 241, datë 20.04.2023.

EMËRTIMI / POZICIONI	PAGA MUJORE			
	Paga individuale			Shtesa e pozicionit
	Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikimin (SHK)	
1	2	3	4	5
Edukator në kopsht fëmijësh	1	2% e PG	5% e PG; 10% e PG; 20% e PG	48.000
Edukator në kopsht fëmijësh	2	2% e PG	5% e PG; 10% e PG; 20% e PG	44.400

Lidhja nr. 6 – Niveli i pagave për punonjësit e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri. Bazuar në vendimin nr. 350, datë 19.04.2017 të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, i ndryshuar VKM nr. 240, datë 20.04.2023.

Niveli	Grada	Paga bazë për gradë	Shtesa për natyrë të veçantë pune	Vjetërsia
Niveli bazë	Asistent zjarrfikës	46.000	7.000	1%
	Zjarrfikës	52.500	8.000	1%
	Kryezjarrfikës	55.000	8.000	1%
Niveli i mesëm	Inspektor zjarrfikës	64.200	6.000	1%
	Kryeinspektor zjarrfikës	74.500	6.000	1%
	Komisar zjarrfikës	97.500	6.000	1%

Punonjësit e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për çdo vit vjetërsi shërbimi, përfitojnë shtesë mbi pagë, në masën 1 për qind për çdo vit, deri në 25 vjet. Kjo shtesë llogaritet mbi vlerën e pagës bazë të gradës “Asistent zjarrfikës”. Për efekt të llogaritjes së kësaj shtese, vite shërbimi do të konsiderohen vitet e qëndrimit në gradë, të dokumentuara në librezën e punës së çdo punonjësi, në strukturat e Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, Forcave të Armatosura, Policisë së Burgjeve, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, Policisë së Shtetit si dhe në strukturat e Shërbimit Informativ të Shtetit.

Lidhja nr. 7 – Niveli i pagave për nëpunësit e gjendjes civile. Bazuar në lidhjen nr. 12, të vendimit nr. 325, datë 31.05.2023 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve

të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”.

Emërtesat e pozicioneve të punës	Klasa e pagës	Grupi i diplomës	Paga për pozicion
Përgjegjës i zyrës së gjendjes civile në bashki	IV-2	1	70.000
Përgjegjës i zyrës së gjendjes civile në njësi administrative	IV-3	1	60.000
Specialist i zyrës së gjendjes civile në bashki	IV-3	1 ose 2 ose 3	60.000
Specialist i zyrës së gjendjes civile në njësi administrative	IV-4	1 ose 2 ose 3	50.000

Shënim: Shtesa për vjetërsi në punë për punonjësit e gjendjes civile jepet në masën:

1. 0.6% pas çdo viti pune për 10 vitet e para (1–10 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;
2. 0.8% pas çdo viti pune për 10 vitet e dyta (11–20 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;
3. 1% pas çdo viti pune për 10 vitet e treta (21–30 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;

Lidhja nr. 8 – Niveli i pagave për administratorët e njësive administrative.

Emërtesat e pozicioneve të punës	Paga bazë
Administrator i NJ.A. Himarë	90.000
Administrator i NJ.A. Lukovë	90.000
Administrator i NJ.A. Horë – Vranisht	80.000

- Niveli i shpërblimit për këshilltarët e Këshillit Bashkiak dhe kryetarët e fshatrave.

- 1 – Anëtarët e Këshillit Bashkiak 10% të pagës së Kryetarit të Bashkisë: **12.500 lekë** në muaj.
- 2 – Kryetarët e fshatrave 10% të pagës mujore të kryetarit të këshillit: **1.250 lekë** në muaj.

KRYETARI I BASHKISË

Jorgo Goro



Drejtore i DFPBIE
Laert Mezani

Drejtore i DBNJSHM
Andon Xani

DREJTORIA JURIDIKE

Klejli Muharremi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. 3249 / 2 prot.

Himarë, më 13.07.2023

RELACION SQARUES

Lënda: Për miratimin e projektvendimit “Për disa ndryshime në vendimin nr. 56, datë 24.11.2022 ‘Për miratimin e numrit të përgjithshëm dhe nivelin e pagave të punonjësve të Bashkisë Himarë për vitin 2023’”

KËSHILLIT BASHKIAK HIMARË

Në kuadër të ndryshimeve ligjore në lidhje me pagat me miratimin e ligjit nr. 35/2023 “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi” dhe miratimin e VKM-ve të reja për nivelet e pagave janë bërë disa ndryshime në nivelin e pagave për të gjithë punonjësit e Bashkisë Himarë.

Këto ndryshime janë pasqyruar në lidhjet nr. 1,2,3,4,5,6,7 e 8 të projektvendimit që ju kemi paraqitur për miratim, të cilat do të zevendësojnë lidhjet me të njëjta numra në vendimin nr. 56, datë 24.11.2022 “Për miratimin e numrit të përgjithshëm dhe nivelin e pagave të punonjësve të Bashkisë Himarë për vitin 2023”.

Për sa ju parashtroam në këtë relacion, bazuar në kërkesat e pikës “ç”, të nenit 54, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetqeverisjen vendore”, i ndryshuar dhe nenit 9, të ligjit nr. 35/2023 “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”, kërkojmë miratimin e këtij projektvendimi me lidhjet e reja të pagave, nga ana e Këshillit Bashkiak.

KRYETARI I BASHKISË

Jorgo Goro

Drejtor i DFPBIE

Laert Mezani

DREJTORIA JURIDIKE

Klejli Muharremi



Drejtor i DBNJSHM

Andon Xani